

VENDIM
Nr. 567, datë 24.6.2015

PËR FINANCIMIN E KOSTOS SË MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE QË ZBATOHEN
NGA FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja “a”, e 4, dhe 8, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e koston së menaxhimit të projekteve të qeverisë shqiptare që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në një vlerë, jo më shumë se 98 000 000 (nëntëdhjetë e tetë milionë) lekë, e cila të përballohet nga zëri “Kosto lokale”, miratuar në buxhetin e vitit 2015 për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.
 2. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama